

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar
ADRESA	https://dosja.al/live-updates/fjalim-i-turpshe-ne-okb-berisha-rama-eshte-armik-i-eger-i-kosoves--i516166
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 13:09:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 12:58:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	e9b41b733ad784c5b16614cb69942873995ee68dfdc324b5a27886842cc45485
TEKSTI	0dc92f28d3cb901e1a566d7a0f47b14efa4ecfa75cc7765f2ad5b03a33ac676d
PAMJA	8ac765b20ce3ac4eca44d6f9cbfc93663864b0ac0c2f9d08efd5d04509aa3670

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	606866f987ea543644083c8a2ed84b7acbaca5c5e963ebbf2ef4241135654c75
E MËPARSHMJA	27cdcb748cccaf3ea41da3f569debdaa11e7dbe2c79bc843d04d1a72bb031ffe
RRËNJA MERKLE	37fa8ea76a78e5b04e7fbef6a77a32a9f5044a1541a67ae3d0621621d26aebcc
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/606866f987ea543644083c8a2ed84b7acbaca5c5e963ebbf2ef4241135654c75>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES

35 MINUTA ME PARE

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

1 ORE ME PARE

Shpërthimi i fuqishëm në lagjen Plaka në Greqi/ Humbin jetën 6 persona, mes tyre dhe 3 shqiptarë të pajetë në rrënoja (EMRAT+PAMJET)

3 ORE ME PARE

Zyrtarisht në detyrë/ Eric Wendt dorëzon letrat kredenciale, nis misionin si ambasador i SHBA-së në Shqipëri

3 ORE ME PARE

SPAK aksion në Shkodër e Tiranë/ Goditet grupi kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

LIVE UPDATES

Ceremonia e prezantimit të Wendt si ambasador i SHBA në Shqipëri, Berisha: Nuk kam dijeni, në mbledhjen e Këshillit të Sigurisë Kombëtare nuk jam ftuar

• Kryetari i Partisë Demokratike, Sali Berisha, e ka cilësuar si 'të turpshëm' fjalimin e kryeministrit Edi Rama në Asamblenë e Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara, duke akuzuar atë se nuk përmendi Kosovën dhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. • Në bashkëbisedimin e përjavshëm me qytetarët, Berisha tha se Rama kishte zgjedhur që fjalimin në OKB ta përqendronte te inteligjenca artificiale dhe jo te çështjet që, sipas tij, lidhen me interesat kombëtare shqiptare. • Sipas tij, kryeministri shqiptar ka mbajtur një qëndrim të kundërt me atë të kryeministrit të Kroacisë, i cili foli për zhvillimet në Kosovë dhe rajon. • Lideri i opozitës e lidhi këtë qëndrim edhe me raportet e Ramës me qeverinë e Kosovës. • Ai akuzoi gjithashtu Ramën se po përpiqet të paraqesë Lëvizjen Vetëvendosje si një forcë politike kundër Shqipërisë. • Sipas Berishës, një pretendim i tillë është i pabazuar. • Në bashkëbisedimin online me qytetarët, Berisha foli edhe për arrestimin e ish-drejtoreshës së Shërbimit Informativ Shtetëror, Vlora Hyseni. • Ai e cilësoi këtë zhvillim si një prej skandaleve më të rënda dhe pretendoi se përgjegjësia politike për çështjet që lidhen me sigurinë e vendit shkon deri te kryeministri Rama. • Kryedemokrati përsëriti edhe akuzat e tij ndaj qeverisë për lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin. • Ai deklaroi se ka, sipas tij, 'prova direkte të mëdha' për Edi Ramën dhe kritikoi SPAK-un për faktin që, sipas tij, nuk e ka marrë kryeministrin në pyetje për një sërë çështjesh. • Berisha foli edhe për protestat kundër qeverisë, duke paralajmëruar një aksion më të gjerë opozitar. • Berisha bëri thirrje demokratëve për 'mobilizimin më të madh', ndërsa tha se strategjia e opozitës do të jetë ripërtëritja e Partisë Demokratike dhe rritja e presionit politik ndaj qeverisë. • Ai deklaroi se PD do të krijojë një agjenci kombëtare që, në rast të ardhjes në pushtet, do të hetonte dhe konfiskonte pasuritë që do të rezultonin të paligjshme. • Kryetari i Partisë Demokratike u bëri sërish thirrje qytetarëve dhe simpatizantëve që të vazhdojnë 'betejën' kundër qeverisë dhe të bëhen pjesë e protestës së përditshme qytetare.

6 artikuj për këtë temë.

2 ORE ME PARE

Berisha i uron mirëseardhjen ambasadorit të ri: SHBA do të japë një ndihmë substanciale për çmontimin e narkoshtetit



editoriale

Auron Janku

"Washingtonët" tanë

Eriseld Zeneli

Shqipëria, socializmi i Edi Ramës pa të majtën

Në vëmendje



Sali Berisha

TIRANA- Kreu i Partisë Demokratike Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi live me ndjekësit e tij në rrjetet sociale i ka uruar mirëseardhjen ambasadorit të ri amerikan në Shqipëri, duke u shprehur se beteja kundër narkoshtetit është një betejë e vështirë.

Gjatë fjalës së tij, Berisha bëri një paralelizëm të Shqipërisë me vendet afrikane duke e cilësuar atë si të vetmin narkoshtet në Evropë. Ai theksoi edhe fjalën e sekretarit Marco Rubio në lidhje me luftën kundër kartelëve të drogës pasi shihen si kërcënim për sigurinë e qytetarëve ndërsa, sipas kreut të opozitës, kartelët shqiptarë janë rrezik jo vetëm për Shqipërinë por për mbarë botën.

"Së pari i uroj mirëseardhjen ambasadorit dhe theksoj këtu se beteja kundër narkoshtetit është një betejë shumë e vështirë. Ne jemi i vetmi vend në Europë, ne jemi njëloj si Guinea-Bissau që ishte vendi i parë dhe i vetëm narkoshtet në Afrikë, ne u bëmë vendi i parë dhe i vetëm narkoshtet në Evropë. Dhe unë kam besim se me pozicionimin dhe kualifikimin që iu ka bërë presidenti Trump dhe administrata e tij kartelëve të drogës si grupe terroriste, Shtetet e Bashkuara do japin një ndihmë substanciale për luftën kundër këtyre kartelëve dhe çmontimin e narkoshtetit në Shqipëri. Sekretari Rubio, edhe një herë të dashur miq, në mesazhin e tij të urimit për shqiptarët Ditën e Pavarësisë, e konsideron luftën kundër kartelëve të drogës dhe bashkëpunëtorëve të këtyre kartelëve, po dihet se kush janë bashkëpunëtorët, si kritike për sigurinë e qytetarëve të Shteteve të Bashkuara. Sepse në fakt këto kartele, kartelët shqiptarë janë një rrezik jo vetëm për Shqipërinë, por Evropën, për hemisferën perëndimore dhe mbarë botën," tha Sali Berisha./Dosja.al

2 ORE ME PARE


Berisha: Provat direkte më të mëdha i kam për Edi Ramën, por SPAK nuk guxon ta thërrasë



Sali Berisha

TIRANA- Kreu i Partisë Demokratike, Sali Berisha gjatë një bashkëbisedimi live në rrjetet sociale me ndjekësit është pyetur për prova dhe informacionet që lidhen me persona të tjerë të dyshuar se kanë lidhje me krimin e organizuar. Gjatë fjalës së tij, Berisha është ndalur te kryeministri i vendit Edi Rama, duke theksuar se ka prova për përfshirjen e tij në disa çështje.

Njëkohësisht, ai ka akuzuar SPAK-un, me pretendimet se nuk ka ndërmarrë veprime ndaj Ramës për një sërë çështjesh që ai i ka denoncuar publikisht. Kreu i PD-së e ka përfunduar fjalën e tij duke kërkuar që kryeministri Rama të vendoset në bankën e të akuzuarit, pasi kjo është zgjidhja e vetme për të luftuar kriminalitetin.



AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 14:13

Atentati në Athinë/ Në shënjestër 30-vjeçari Denis Luli! Dyshimet se urdhri u dha nga Klodian Lekocaj, i njohur si kreu i mafies së burgjeve

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:36

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës

AKTUALITET 26 SHTATOR 2026, 11:14

U arrestua nga SPAK gjatë operacionit "Muri i Lartë"/ Kush është Bledar Çafi, "i forti" i Shkodrës ndër vite i përfshirë në botën e krimit

më të klikuarat

VIDEO/ Pamje të rënda nga atentati në Sarandë! Artan Myrtaj vrapon për tu shpëtuar plumbave, autorët e ndjekin dhe qellojnë në mes të rrugës

Në kërkim nga SPAK/ Si i shpëtoi policisë ish-anëtari i bandës së Durrësit Indrit Dokle! Planet e Ervis Martinajt për ta eliminuar dhe armiku i Lul Berishës



SPAK operacion në Shkodër e Tiranë/ Goditet një grup kriminal i trafikut të drogës! Urdhërarrest për Indrit Doklen, në pranga Bledar Çafi (VIDEO)

Aksioni i SPAK kundër grupit Rraja/ Shkon në 17 numri i të dyshuarve, Indrit Dokle i akuzuar për trafik ndërkombëtar droge

insights

Klodian Lekocaj



Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gagani
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Pyetje: Doktor, akuzat tuaja kanë rezultuar gjithmonë të sakta. SPAK ka goditur individët që ju keni denoncuar vite më herët edhe pse mund të themi që puna e këtij institucioni lë shumë për të dëshiruar. Shqiptarët duan konfiskim të pasurive të vjedhura dhe kthimin e tyre tek shqiptarët. Gjithsesi, a mund të na tregoni sot ndonjë informacion ekskluziv për ndonjë zyrtar tjetër të implikuar me krimin e organizuar nga qeveria e Ramës? Në parlament pyetët ministren Ismaili nëse kishte qenë në zyrën e Agasit. A mund të dimë çfarë provash keni për këtë?

Sali Berisha: Tani, do më falësh po unë prova direkte të mëdha kam për Edi Ramën. Kam direkt për Edi Ramën! Edi Rama ka dërguar në Aruba përfaqësuesit e tij në takimin trepalësh. Pra, takimi që është zhvilluar në Aruba midis bosëve të drogës, ndërtuesve dhe përfaqësuesve të Edi Ramës është bërë totalisht me urdhër të Edi Ramës. Edi Rama ka pritur bosin e Sinaloas meksikane Luftar Hysin dhe kjo është e faktuar. Vëllai i Edi Ramës, Olsi Rama, është protagonist kryesor i klanit të Xibrakës dhe fabrikës së miellit që u ndërtua në Xibrakë në vitin 2013-2014. Këto janë të faktuara të gjitha zotëri, por SPAK-u nuk vepron. Edi Rama është autori i kanabizimit të plotë të Shqipërisë. Është njeriu që përpunoi doktrinën e drogës si doktrinë e pasurimit të tij dhe të bosëve të tjerë. Pra, po të më pyesësh sot, Belinda Balluku, Olsi Rama, Saimir Tahiri, Damian Gjiknuri, Engjëll Agaçi, Vlorë Hyseni, Ergys Agasi, Vangjush Dako dhe cilido, të gjithë pa përjashtim janë ushtarë të Edi Ramës.


Kështu që problemi më kryesor është ky, se SKAP nuk guxon ta thërrasë Edi Ramën. Nuk guxon ta thërrasë ta marrë në pyetje për Arubën. Nuk guxon ta thërrasë ta marrë në pyetje për Luftar Hysën. Nuk guxon ta thërrasë ta marrë në pyetje për 140 milionë euro të djegësit të Tiranës, të cilit ai me firmën e tij ia dha kompanisë 8 muaj para se ajo të regjistrohej në QKB. Nuk guxon ta thërrasë ta pyesë për 300 milionë euro koncesione të shëndetësisë. Dilte nga studio në studio Edi Rama, me një gërshtë të thyer dhe një pincë të ndryshkur, thoshte 'ja me se operohet' ky mashtues ordiner i pafytyrë. Në një kohë që me koncesionin rriste koston për sterilizim, sipas organeve zyrtare shqiptare, 83 herë, vetëm që të vidhte me ministrin e tij. Dhe, në qoftë se Beqja bëri burg dhe është gjoja në proces për paratë që ai ka shpenzuar në restorantin e tij, para të BE, nuk ka asnjë akuzë për sterilizimin, nuk ka asnjë akuzë për analizat, nuk ka asnjë akuzë për check-up-in, sepse janë të gjitha veprat e Edi Ramës.

SPAK-u nuk guxon të thërrasë Edi Ramën për të gjitha porositë, 60% e dosjes Balluku është dosja e Edi Ramës. Nuk guxon ta thërrasë Edi Ramën për 120 milionë euro të Bekeut, gjobë Shqipërisë. Nuk guxon ta thërrasë Edi Ramën për përzënie e Pacollit nga aeroporti i Vlorës që do shkojë të paktën 600 milionë euro. Por përsëri mund të bëj një listë të tërë. Kështu që, në zyrën e Agasit kanë kaluar me dhjetëra ministra, deputetë, gjyqtarë, prokurorë. Lidhur me atë zonjën, se paska bërë një koment ajo, nuk ka pasur asnjë kuptim tjetër fjala ime përveçse politik. Po atyre u shkon mendja mbarë e mbrapsht e pastaj m'i veshin mua ato që unë s'i them. Jo, sepse atje shkonin ministrat e i thoshin: 'na e ndërro pak ministrin'. Pra, kur flas për zyrën e Agasit, në parlament dhe kudo, unë flas për angazhimin e tij të tmerrshëm në politikë. Këto janë. Gjithkuri? Po ka qenë Gjithkuri. Një javë shkon në Batoped, në Athos, për të larë gjynahet atje. Nga ana tjetër shkon e futet në zyrën e Agasit. Atje është shumica. Aty kanë qenë, aty diskutohej e tërë politika, ministrat e brendshëm, aty shkarkoheshin. Po, po. Shumë e vërtetë. Ndaj dhe ka vetëm një zgjidhje, vendosni Edi Ramën para drejtësisë. Nuk ka luftë kundër kriminalitetit të vërtetë në qoftë se Edi Rama nuk shkon në bankën e të akuzuarit./Dosja.al

2 ORE ME PARE

Berisha: Sulmi i Ramës ndaj Joe Biden për dënimin e Thaçit është një paturpësi ekstreme





TIRANA- Kreu i Partisë Demokratike Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi live në rrjetet sociale me ndjekësit e tij, ka diskutuar në lidhje me deklaratat e kryeministrit të vendit Edi Rama për ish-presidentin amerikan Joe Biden dhe ish-presidentin e Kosovës, Hashim Thaçi.

Berisha e ka cilësuar deklaratën e bërë nga kryeministri Rama si paturpësi ekstreme, dhe ka theksuar se presidenti Biden gjatë gjithë karrierës së tij votën dhe qendrimin e ka pasur në favor të shqiptarëve. Ai ka kundërshtuar njëkohësisht pretendimet se ky i fundit ka tradhtuar ish-presidentin Thaçi, duke thënë se prapa proceseve dhe dënimeve fshihet vetë Rama.

"Një paturpësi ekstreme. Joe Biden nuk është më president, por e thashë dhe më parë, në të gjithë karrierën e tij, ai votën dhe qëndrimin e ka pasur në favor të shqiptarëve. Nuk ekziston asnjë dokument në botë që Joe Biden t'i ketë premtuar një njeriu apo një tjetri se do ta mbrojë nga gjyqimi dhe drejtësia. Të shfrytëzosh një vendim të padrejtë të një gjykate për të shpallur ish-presidentin e Shteteve të Bashkuara tradhtar të Hashim Thaçit, pra njeri të pabesë ndaj këtij individi, do të thotë të jesh i zhveshur nga çdo normë morale. Dhe të kesh një hall aq të madh në këtë çështje, sa je i gatshëm të thuash çdo gjë. Por në fakt, ai që qëndron prapa këtyre proceseve dhe dënimeve është vetë Edi Rama," tha Berisha./Dosja.al

3 ORE ME PARE

Fjalimi i Ramës në OKB/ Berisha: Ai është armik i egër i Kosovës, tani po përhap shpifje të ulëta kundër Vetëvendosjes



TIRANA- Kreu i Partisë Demokratike Sali Berisha, gjatë një bashkëbisedimi live në rrjetet sociale me ndjekësit e tij, ka folur në lidhje me fjalimin e mbajtur nga kryeministri i vendit Edi Rama në Organizatën e Kombeve të Bashkuara të cilin e ka cilësuar si të turpshëm.

Gjatë fjalës së tij ai ka kritikuar ashpër kryeministrin Rama duke e akuzuar se gjatë fjalimit në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së nuk e përmendi vendimin ndaj ish-krekrëve të UÇK-së. Njëkohësisht, ai ka folur për marrëdhëniet mes Tiranës dhe Prishtinës, duke i kundërshtuar deklaratat se Lëvizja Vetëvendosje është kundër Shqipërisë dhe duke paraqitur qëndrimet e tij mbi rolin e qeverisë shqiptare në raport me Kosovën



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.